ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**KRURGJA-24-9965-5-1-1**
Nr i brendshëm	**KRURGJA-24-038-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: "Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hilë dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës".

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

DIAMANTI SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Naim Frashëri" Nr-16

(Adresa)

Prishtinë ***10000***

(Vendi) ***(Kodi postar)***

+38344776839

(Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Azem Tahiraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkdiamanti@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) ***(Nënshkrimi dhe vula)***

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1.Njoftimi për kontratë është publikuar me datë: 02.10.2024 2.Data e hapjes së ofertave: 13.11.2024 3.Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 06.12.2024 4.Kërkesa për rishqyrtim:11.12.2024 5.Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:16.12.2024 6.Ankesa 24.11.2025 7.Ekspertiza nr. 2024/1264 i dt.09.01.2025 8.Vendimi i OSHP-së nr. 2024/1264 i dt.12.03.2025 9.Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 17.04.2025 10. Kërkesa për rishqyrtim:22.04.2025 11.Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:29.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Vendimi i OSHP-së nr. 2024/1264 i dt.12.03.2025

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sqarim/Kronologji

Gjatë vlerësimit të parë, neve kishim pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm përmes platformës elektronike e-prokurimi me dt. 06.12.2024, ndërsa autoriteti kontraktues kishte rekomanduar për kontratë Grupin e OE : FIDANI-L SHPK KUSHTIMI NM , i cili as për se afërmi nuk i kishte plotësuar kërkesat e FDT -së.

Pas këtij njoftimi ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe më pastaj ankesë në OSHP, ku vendimi i OSHP-së është nxjerr me dt. 12.03.2025 nr. **2024/1264.**

Vendimi i OSHP-së ka aprovuar pjesërisht ankesën tonë dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim. Në lidhje me pretendimin tonë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe se nuk ka plotësuar kërkesën për kontrata dhe punë të ngjashme, paneli shqyrtues ka konstatuar si më poshtë:

Lidhur me pretendimin e parë ankimor të parashtruar nga OE ankues i cili pretendon se AK ka rekomanduar një OE i cili nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Seksionin II të Fletës së të DT, konkretisht për kriteret mbi kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, në pikat 9.1 dhe 9.2. sa i përketë përmbushjes së kërkesës për projekte të ngjashme me natyrën e aktivitetit të prokurimit, PSH gjatë shtjellimit të dokumetacionit vëren se OE i rekomanduar ka dorëzuar një mori dokumentacioni që OE i rekomanduar i ka vlerësuar se janë punë të ngjashme me punët dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit megjithatë e obligon AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë në zbatim të nenit 72 në mënyrë që të argumetohet se a janë plotësuar kërkesat e parashtruara në DT, rrjedhimisht PSH konstaton se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor për saldues, paneli shqyrtues ka konstatuar si më poshtë:

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor të parashtruar nga OE ankues i cili pretendon se AK ka rekomanduar një OE i cili nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues konkretisht pretendon se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesën në dosje tenderi: (2) saldues të çertifikuar për saldimin e gypave PE., Paneli shqyrtues veren se në këtë pretendim janë atakuar kryesisht afatet e çertifikimit të cilat nuk janë kërkuar decidivisht në DT, andaj me qëllim të një përgjigje të saktë PSH e obligon AK gjatë rivlërsimit në zbatim të dispozitave ligjore të nenit 59.4 të LPP të bëjë kontroll efektiv dhe në këtë mënyrë të sqarohen çertfikatat e dorëzuara nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, rrjedhimisht PSH konstaton se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Autoriteti kontraktues pasi që e ka kthyer lëndën në rivlerësim, tani me dt.17.04.2025 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku pas rivlerësimit përsëri ka rekomanduar për kontratë grupin e OE FIDANI-L SHPK KUSHTIMI NM.

Ne si OE kemi kërkuar qasje në dokumentet e tenderit, për të vërtetuar faktin se a janë kërkuar sqarime shtesë nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, ashtu siç është konstatuar në vendimin e OSHP, ku AK-ja është detyruar të kërkoj sqarime shtesë.

Me dt.22.04.2025 na është lejuar qasja në dokumentet e tenderit, ku nga AK-ja na është ofruar vetëm raporti i komisionit vlerësues për rekomandim i përpiluar nga Komisioni i vlerësimit për aktivitetin e prokurimit, i cili i është dorëzuar zyrës së prokurimit.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Kur analizohet raporti i lartcekur, shihet qartë se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtesë fare nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë edhe pse me vendimin e OSHP-së kanë qenë të detyruar të kërkojnë sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë.
Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së duke bërë shkelje të dispozitave ligjore përkatësisht të njëjtat veprime bëjnë pjesë në shkeljet e rënda të cilat parashihen në pikën h) të nenit 97 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Pasi që autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, këtu shihet qartë se pretendimet tona ankimore janë të qëndrueshme, sepse në të kundërtën AK-ja do ti kishte kërkuar sqarimet nga i njëjti OE.
Përderisa nuk janë kërkuar sqarime shtesë dhe nuk është vërtetuar e kundërta e pretendimeve tona ankimore, atëherë ne jemi të detyruar të parashtrojmë përsëri kërkesë për rishqyrtim me arsyetimet e njëjta sikurse në kërkesën e kaluar për rishqyrtim.

Pretendimi 1:
Kërkesë në dosje tenderit ka qenë: *Operatori Ekonomik duhet ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të ngjashme me natyrën e kontratës (Projekte të ujësjellësit që përfshijnë rezervuarët, gypat, instalimin e pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm si dhe projektet me instalimet e ujësjellësve për ujitje) në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej së paku 1.000.000,00 €. Nëse aplikohet ne grup, lideri duhet ti ketë së paku 60% të vlerës së kërkuar të punëve të kryera referencave.*
1.Nje liste e puneve nga Operatori Ekonomik duke saktesuar punet e kryera ,shumen e kontrates dhe kohen. Listes ti bashkangjiten si deshmi (i) kur punet jane bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtyre puneve shërben kopja e certifikatës (certifikata ose raport pranimi ose referenca) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë. (ii) kur punet jane bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtyre puneve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga bleresi dhe evidentimi i punimeve të tilla; (Referencat ose raportet e pranimit te puneve duhet te jete ne perputhje me listen e prezantuar.)

Grupi i OE "FIDANI-L SHPK KUSHTIMI NM të cilin autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm për faktin se të njëjtit nuk e kanë plotësuar kërkesën e lartcekur.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar (plotësuar) listën e kontratave të realizuar në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë me saktësisht nuk ka prezantuar certifikata ose raport pranimi ose referenca në vlerën prej 1.000.000,00 € për punë të ngjashme.

1.1 Lideri i konsorciumit FIDANI-L SHPK ka prezantuar vetëm dy referenca për Projekte të ujësjellësit që përfshijnë rezervuarët, gypat, instalimin e pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm si dhe projektet me instalimet e ujësjellësve për ujitje) ne vlere prej 496,354.68 euro, çka nënkupton se nuk e plotëson kërkesën e DT.

a) **Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar referenca sipas dosjes së tenderit për instalime te ujësjellësit (rrjet te ujësjellësit dhe instalim te pjesëve fazonike, por ka prezantuar referenca për pune ndërtimore (çka dallon shumë kanali betonit me instalime te ujësjellësit) referenca me numër rendor 7 dhe 8 ne listën e kontratave e ku AK-ja i konsideron si referenca valide, gjë që sipas mendimit tone këto veprime të AK-së janë jo profesionale, tendencioze, te dyshimta dhe te palogjikshme, çka do te thotë se është veprim favorizues, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm me çmim me te ulet.**

1.2 **Grupi i OE** "FIDANI-L SHPK gjithashtu ka prezantuar referenca të tjera që nuk janë në përputhshmëri (nuk e plotësojnë) kërkesën dosjes së tenderit, sepse në kërkesë është kërkuar specifikuar saktë referenca (Projekte të ujësjellësit që përfshijnë rezervuarët, gypat, instalimin e

DIAMANTI SH.P.K Prishtinë

pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm si dhe projektet me instalimet e ujësjellësve për ujitje, e jo referenca për kanale te betonit për ujitje, qe nuk përfshinë as gypat, instalimin e pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm si dhe projektet me instalimet e ujësjellësve për ujitje, gjë që është dëshmuar edhe pas kërkesës për sqarime shtesë për prezantimin e kontratës dhe paramasës ku në asnjë pozicion në paramasë nuk ka pune që përfshinë instalimet e ujësjellësve si gypat, instalimin e pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm, por ka vetëm pozicione për punim te kanalit te hapur me dimensione 50x50,gje qe nuk e plotëson kërkesën ne DT.

1.3 Pra, autoriteti kontraktues ka treguar njëanshmëri të plotë në raport me Grupin OE e rekomanduar për kontratë sepse përmes letrës standarde për sqarime shtesë të dt. 25.11.2024, është munduar që referencat për kanal të hapur ti llogarit si referenca për instalimet e ujësjellësve sipas kërkesës në DT, ku me këtë rast ka bërë shkelje ligjore, sepse asnjë pozicion në paramasën e prezantuar nga OE FIDANI-L SHPK nuk ka paraparë punë të instalimeve të ujësjellësve.

1.4 Gjithashtu edhe partneri i parë KUSHTIMI NM nuk ka arritur të dëshmoj se posedon referenca te mjaftueshme konform kërkesës në DT.

Përderisa Grupi OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar konform kërkesës së lartcekur atëherë është i qartë fakti se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një gjë e tillë nuk ka ndodhur për shkak se AK-ja ka favorizuar një OE të papërgjegjshëm, duke e rekomanduar për kontratë.

Pretendimin tonë të lartcekur e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij dhe njëkohësisht edhe paneli shqyrtues i OSHP-së, ku është aprovuar pjesërisht i bazuar pretendimi ynë dhe është obliguar AK-ja që konform nenit 72 të kërkoj sqarime shtesë, me qëllim të vërtetimit të faktit se a janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit apo jo.
AK-ja nuk e ka respektuar fare vendimin e OSHP-së dhe ky fakt vërtetohet nga qasja që kemi pasur në dokumentet e tenderit, pas rivlerësimit neve nuk janë prezantuar dëshmi që janë kërkuar sqarime shtesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë. Normalisht që nuk janë kërkuar sqarime shtesë sepse nuk ka dëshmi për ët vërtetuar të kundërtën ky grup i OE të rekomanduar për kontratë.

Pretendimi 2:
Kërkesë në dosje tenderit: (2) saldues të çertifikuar për saldimin e gypave PE.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar, **(2) saldues të çertifikuar për saldimin e gypave PE.**

a) Grupi i OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën e lartcekur ka prezantuar disa certifikata për vijim të trajnimeve për saldues, të cilat certifikata janë pa datë të skadimit (vlefshmërisë), që do të thotë se të njëjtit nuk janë saldues të certifikuar siç specifikohet në "Dosjen e Tenderit", por janë vetëm pjesëmarrës në trajnimet e mbajtura.

Janë prezantuar dy certifikata për Kushtrim Misini dhe Egzon Misini, certifikata të cilat janë pa datë të skadimi të lëshuara nga një qendër aftësimi në Prizren ku pas një hulumtimi tek **Drejtoria e Akreditimit e Kosovës - DAK kjo qendër aftësimi nuk ka akreditim për certifikim për saldues te gypave PE, certifikata të lëshuara të cilat mund të janë edhe fiktive dhe mund të merren kudo dhe kurdo, pra AK-ja është dashur të ketë parasysh se çfarë certifikata po ju prezantohen dhe duhet të kryej kontroll efektiv të dokumentacionit.**

b) Sa për sqarim certifikata për saldimin e gypave të POLIETILENIT të cilat lëshohen nga kompanitë e akredituara, posedojnë një date të lëshimit dhe datë të skadimit që do të thotë se këto certifikata nuk janë të përhershme.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

c) Certifikatat e prezantuara për Petrit Mulaj nga "AQScert" certifikata e cila tregon se është pjesëmarrës në trajnim, pra ka vijuar trajnimin për saldime, por nuk është saldues i certifikuar.

Ky pretendim i yni është i bazuar, pasi që ky informacion na është konfirmuar edhe përmes bisedës telefonike nga trupi certifikues nga Shqiperia "AQScert", per arsye se "AQScert" nuk është i akredituar për certifikim për saldim të gypave PE.

d) Për Petrit Mulaj është prezantuar edhe një certifikatë nga **Austrian Institute of Excellence** e cila është i vetmi trup i akredituar për të certifikuar persona për saldime te gypave PE, certifikate e cila i ka kaluar afati skadencës, pra kjo certifikatë ka skaduar me dt. 23.03.2024.

Nga këto dëshmi vërehet qartë favorizimi i kompanisë fituese, pasi që vlerësimi i tenderëve nuk është bërë në mënyrë profesionale.

Pretendimin tonë të lartcekur e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin e saj nr. 2024/1264 të dt.12.03.2025, ku sipas këtij vendimi pretendimi ynë është aprovuar si pjesërisht i bazuar, ndërsa AK-ja ka qenë e obliguar që konform dispozitave të nenit 59.4 të LPP dhe 52.7 të LPP-së të bëjë kontroll efektiv dhe në këtë mënyrë të sqarohen certifikatat e dorëzuara nga e OE të rekomanduar për kontratë.

Autoriteti kontraktues përveç që nuk ka vepruar konform vendimit të OSHP-së e njëjta ka vazhduar përsëri me shkeljet e saj pasi që e ka rekomanduar përsëri të njëjtin OE për kontratë, edhe pse në asnjë mënyrë nuk ka mundur të dëshmoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore. Nëse eventualisht OE i rekomanduar për kontratë do të ishte i përgjegjshëm, atëherë AK-ja me fakte konkrete do të dëshmonte një gjë të tillë, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë.

Pretendimi 3:

Kërkesë në dosje tenderit : Një (1) aparat për saldimin ballor të gypave PE për profile deri DN400. Listës se pajisjeve t'i bashkëngjiten këto dëshmi- kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (me validitet te regjistrimit) ose DUD – i doganor, ose fatura e blerjes

Po ashtu marreveshes mbi qiramarrjen t'i bashkangjiten këto deshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (me validitet te regjistrimit) , ose DUD – i doganor, ose fatura e blerjes.

Grupi OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën e lartcekur e dosjes së tenderit, nuk ka arritur te paraqes asnjë dud ose faturë sipas kërkesës ne dosje tenderi te prezantoj (faktoj) se e posedon aparat për saldimin ballor të gypave PE për profile deri DN400.

a) Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy aparate në pronësi për saldimin ballor të gypave PE, një aparat me profile prej 125-315 mm, një aparat me profile prej 90-315 mm.

b) Gjithashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me një kompani nga Shqiperia 2T shpk për dy aparate për Saldim gypave me Elektofuzion, të cilët nuk e plotësojnë kërkesës e DT sepse kërkohen që aparatet të jenë për Saldim Ballor e jo me Elektrofuzion siç janë prezantuar në listë e marrëveshjes. Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmoj me fatur ose dud-doganor që posedon në pronësi këtë mekanizëm kompania 2T shpk, por vetëm ka prezantuar disa fotografi që mund të mirren kudo dhe kurdo.

AK-ja është dashur ta ketë të qarte faktin se këto dëshmi duhet të prezantohen me faturë ose dud-doganor sipas kërkesës ne DT.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një liste të 2T shpk që posedon aparat për saldimi duke prezantuar edhe emrat e furnizuesit dhe numrat e faturave dhe bashkangjet dy fatura me numër tjetër të faturës që në përshkrim ka vetëm materiale ndërtimi dhe paisje teknike. Nga ky fakt kuptohet se faturat e bashkangjitura nuk dëshmojnë se këtë aparat për saldim e posedon në

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

pronësi kompania 2T shpk, dhe njëkohësisht nuk përputhen emrat e furnizuesit dhe numri faturës në listë me numrin e faturave të bashkangjitura.

		PAJISJET TEKNIKE				
		PAJISJET				
		Furnizuesi	Përshkrim	Sasia	Faturë	Datë
	1	Euro Tubi	Saldatrice (Paisje saldimi (bashkim) tubash PE (Polietileni) me Elektrofusion)	3	1538	11/12/2009
	2	Euro Tubi	Saldatrice (Paisje saldimi me Elektrofuzion HDPE(Polietileni me dendësi të lartë) bashkuese nyjesh me elektrofusion)	7	1539	14/12/2009
	3	Plast Italia	Saldatrice (Paisje saldimi (bashkim) tubash PE (Polietileni) me Elektrofuzion)	2	56/A	10/02/2010
	4	Tecno Wellpoint s.r.l	Paisje për testimi e presionit të tubave dhe bashkueseve (nyjeve) deri në 40 bar	4	15	16/02/2010

FATURE TATIMORE SHITJE

Nr. i Serisë 70551749

Data: 17.03.2011

Nr. i Faturës: 62

EMRI I SHITESIT: IRIDE ACQUA GAS.

ADRESA: ETC. BLV. B. CURRI 12/5

TELEFONI: TIRANE - ALBANIA

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT) K71808002H

EMRI I BLERESIT: 2T Shpk

ADRESA: TIRANE

TELEFONI:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT) K01731001M

EMRI I TRANSPORTUESIT:

ADRESA:

TARGA E MJETIT:

ORA E FURNIZIMIT:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT)

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefta pa TVSH	Vlefta e TVSH	Vlefta me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
1	Paisje dhe materiale ndërtimi		1	€ 30000	€ 30,000	6000	€ 36000

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

FATURË FATIMO

Nr. i Serisë 04914538

Data: 30/07/2013

EMRI I SHITËSIT: IREN ACQUA GAS

Nr. i Faturës: 252/2013

ADRESA: GTC. Blvd. Bulevardi 12/5

TELEFONI: TIRANA - ALBANIA

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) K71808002H

EMRI I BLERËSIT: 2T Sh.p.k

ADRESA:

TELEFONI: TIRANE - ALBANIA

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) K01731001M

EMRI I TRANSPORTUESIT:

ADRESA:

TARGA E MJETIT:

ORA E FURNIZIMIT:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefta pa TVSH	Vlefta e TVSH	Vlefta me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
1	Shitje asetesh teknike						
		GUR		30000	30000	6000	36000

Po ashtu ju sqarojmë se në paramasë dhe parallogari ka pozicione gypa prej DN 63 – 400 mm, gjë që grupi i OE të rekomanduar për kontratë **nuk ka arritur të dëshmoj** se **posedon aparat të saldimit me profile 63 mm** dhe **400 mm** me faturë ose dud doganor sipas kërkesës në dosje tenderit dhe për këtë arsye duhet të shpallet i pa përgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë siç ka vepruar AK-ja.

Gjithashtu edhe partneri i pare KUSHTIMI NM ka prezantuar një kontrate shitblerje në mes të Kushtrim Naser Misini dhe KUSHTIMI NM, për shitblerje të disa aparateve të saldimit, mirëpo për të njëjtat nuk ka prezantuar dëshmi që shitësi ka pasur në pronësi makinat e cekura në kontratë, pra nuk ka dëshmi të pajisjeve (Mungon dëshmia), me dud apo faturë sipas kërkesës së dosjes së tenderit ku decidivisht kërkohet se këto paisje duhet të dëshmohen me Libreze,Dud-doganor ose Faturë kërkesë e cila nuk është plotësuar nga Grupi OE i rekomanduar për kontratë.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur të cilësohen edhe nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që nuk kanë ofertuar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit.

Kjo çështje nuk është në lidhje me pajisjet nuk është analizuar në tërësi nga ana e panelit shqyrtues në vendimin e saj nr. 2024/1264 të dt.12.03.2025, pasi që nëse do të analizoheshin në tërësi pretendimi ynë ankimor dhe dëshmitë e prezantuara nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, atëherë shumë lehtë do të vërtetohej fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, ashtu siç e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij.

Pretendimi 4:

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 300 dite pune.".

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Grupi i OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekur për faktin se i njëjti nuk ka prezantuar planin dinamik.

Kur kemi parasysh të gjitha të metat e lartcekura në ofertën e Grupit të OE të rekomanduar për kontratë dhe AK-ja nuk e ka eliminuar, atëherë këtë veprim të AK-së nuk mund ta kuptojmë ndryshe përveç se favorizim i hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë, pasi që nuk është respektuar as vendimi i OSPH-së dhe njëkohësisht ekspertiza e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

-Gjithashtu Grupi i **OE NSHT VIKTORY COM , MARISA SHPK, KUPA SHPK** kuptohet qartë se janë të OE të papërgjegjshëm pasi që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, por vetëm kanë dorëzuar dokumentacion të panevojshëm dhe të pa arsyeshëm, ndërsa këtë e ka konstatuar edhe AK-ja duke e eliminuar përmes letrës standarde në mungesë të stafit profesional dhe mekanizmit.

Operatorët tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë të papërgjegjshëm dhe palë pa interes sepse asnjëri prej tyre nuk kishte parashtruar ankesë gjatë vlerësimit të parë.
Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një grup të OE i cili është i papërgjegjshëm, pasi që i njëjti nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, andaj si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.29.04.2025.

Për pretendimin ankimor 1: OE FIDANI L SH.P.K.; Kushtrimi NM ka prezantuar në listen e kontratave dhe referencat për kryerjen e punimeve në vlerë 1,464,145.99 €.

Duke marre parasysh që kërkesa e AK-së ka qenë edhe për instalimet të ujësjellesit për ujitje dhe pasi që për projekte të ujësjellesit mund të përdoren kanalet e hapura, të mbyllura, ose të kombinuara, ne si AK i kemi konsideruar si të pranueshme projektet e konzorciumit të rekomanduar për dhënje të kontrates.

Në bazë kësaj që u tha më lart dhe duke ju referuar listës së kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit me nr. Rendor; 1, 4, 7, 8.

Kontratat e liderit te konzorciumit Fidani L me numer rendor: 1, 4, 7, 8, vlera e te cilave eshte 1,464,145.99€

Nga kjo qe u sqarua me larte arrijme ne nje konkluzion shume te qarte qe konzorciumi 'Fidani L' dhe 'Kushtrimi NM' e plotesojne kerkesen e AK-se te njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit, madje e tejkalojne edhe vleren e kerkuar nga ana e AK-se.

Ky arsyetim i AK-së është joprofesional dhe i njëanshëm dhe nuk përkon me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që nuk janë cekur kanalet e hapura, të mbyllura apo të kombinuara por kërkesa ka qenë që të ofrohen dëshmi për projekte të ujësjellësit që përfshijnë rezervarët, gypat, instalimet e pjesëve fazonike, pusetat të gjitha me ujë të pijshëm si dhe projektet me instalimet e ujësjellësve për ujitje.
Duke pasur parasysh këtë fakt është shumë e qartë se arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm duke bërë përpjekje që të shmanget vëmendja nga kërkesa kryesore, mirëpo kërkesa është shumë e qartë dhe dëshmitë janë shumë të qarta, që dëshmojnë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekur dhe nuk janë valide kontratat që janë cekur më lartë me numrat rendor siç ka pretenduar AK-së.

Përgjigja e AK-së për dy salduesit e kontestuar ka qenë si më poshtë:

"DIAMANTI" SH.P.K. DIAMANTI Prishtinë

- **Pergjigja nga AK:**
- Dy saldues të çertifikuar për saldimin e gypave PE. AK në asnjë moment nuk ka pasur paqartesi lidhur me datat e çertifikatave të salduesve, madje nuk ka pasur as dyshime që të perdorë nenin 72- Kerkimi i informative sqaruese. Çertifikatat e prezentuara për salduesin Egzon Misini dhe Kushtrim Misini janë të lëshuara nga Qendra per verifikimin e aftësive profesionale në Prizren, ku citohet se pas 600 oreve praktike, kandidatet kanë arritur të kalojnë provimin duke u aftesuar për 'Saldimin e Gypave PE.

Pretendimi lidhur me 2 saldues te çertifikuar per saldimin e gypave PE ku keni pretenduar qe keto çertifikata nuk jane valide pasi nuk kane nje date te skadences.

Çertifikatat e prezentuara per salduesin Egzon Misini dhe Kushtrim Misini jane te leshuara nga Qendra per verifikimin e aftesive profesionale ne Prizren, ku citohet se pas 600 oreve praktike, kandidatet kane arritur te kalojne provimin duke u aftesuar per 'Saldimin e Gypave PE'. Ne asnje moment keto çertifikata nuk jane te leshuara nga 'AQScert' ashtu siq keni pretenduar ne kerkesen tuaj per ri-shqyrtim qe eshte kinse e pa-akredituar e qe nuk keni paraqitur asnje deshmi per kete pohim tuajin.

Te dy salduesit e prezentuar nga konzorciumi I rekomanduar per dhenje te kontrates e plotesojne kerkesen e AK-se duke I bashkengjitur te gjithe deshmine e kerkuar dokumentare.

Nga vetë fakti se AK-së nuk ka kërkuar sqarime na bënë të dyshojmë edhe më shumë se certifikata nuk janë valide dhe mund të janë të manipuluara apo të falsifikuara, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të bëjë verifikime të këtyre certifikatave.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për makinën për saldim ballor, AK-ja është përgjigjur se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë Dudin me nr serik 146200032 për saldimin ballor dhe një faturë nr 1920. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se edhe pse janë prezantuar dëshmitë të cilat i ka përmendur AK-ja nga OE i rekomanduar për kontratë, të njëjtat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse eshte prezantuar aparati per saldim ballor me profile vetëm deri ne DN 355.

Në paramasën e këtij aktiviteti të prokurimit ekzistojnë gypa DN 400, me gjatësi prej 3,625.00 metra, ndërsa në faturën dhe DUD-in e OE të rekomanduar për kontratë janë prezantuar dëshmi vetëm deri në DN 355, që në këtë rast kuptohet që pajisja nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Gjithashtu i njëjti OE në listën e pajisjeve të prezantuara, e ka shënuar që posedon edhe një shtojcë deri në DN 400, mirëpo në asnjë mënyrë nuk është dëshmuar me dëshmi konkrete si faturë dhe DUD.

Andaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se përgjigjja e AK-së është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".
Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu po ju informojmë se pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, me gjithë këto mangësi te dokumentacioneve të OE të rekomanduar për kontratë, ne e konsiderojmë këtë tender të kurdisur, prandaj ne jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera kompetente.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "**Diamanti SH.P.K**"- Prishtinë
ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM.**
DETYROHET AK-ja që rivlerësimin e ofertave ta bëjë sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform **kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë,** sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 10,000.000 euro.

DIAMANTI SH.P.K Prishtinë

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

"DIAMANTI" SH.P.K. DIAMANTI Prishtinë